



REPUBLIKA E SHQIPERISE

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME VLORE SH.A

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Pune Publike

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Ndërtim I Rrjetit të Kanalizimeve nga Lungomare deri në hyrje të Radhimës, Vlorë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45247130-0 punime ndertimi për ujësjetlës

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetlës Kanalizime Vlore sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kerkesat e pikës 1, Shtojca 7.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit të operatoreve ekonomike.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (të vitit 2024) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare**; ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, paragrafi 1 dhe 2 gërma “b”, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përgjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Në këto kushte, vlerësojmë të kërkojmë këtë dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.***

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar si dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuajduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

U përcaktuan kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriterë janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatëse.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund

të përcaktojë kriteret tjerë të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. **Përvojat e mëparshme** janë element shumë i nevojshëm, që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët të jenë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedurë.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar)*, si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin edhe situacionet përfundimtare dhe formular vleresimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar në DST:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve ekonomikë e shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve,

ku te cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përlllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

- 2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Kategoria NP-1 Punime germimi ne toke	Klasifikimi C
Kategoria NP-4 Rruge,Autostrada,mbikalime hekurudha, tramvai, metro.....	Klasifikimi C
Kategoria NP-7 Ujesjellesa,gazsjellesa,vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	Klasifikimi C
Kategoria NP-12 Punime te inxhinierise se mjedisit	Klasifikimi A
Kategoria NS -1 Punime për prishjen e ndërtimeve	Klasifikimi B
Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike	Klasifikimi C

* Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008).

Mosparaqitja në këtë formë është kusht s`kualifikues.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t`i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publikl” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**; Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet**

e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;” VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 e ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”(të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licencën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit për kategoritë respektive është kërkuar duke u bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, të ndryshuar.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

Kategoria N.P - 1 “Punime gërmimi në tokë” *Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Kjo kategori është kërkuar duke patur parasysh punimet për këtë kategori si: Gërmime dheu me mjetet eskavator etj, që do të kryhen me qëllim zbatimin e projektit “Studim projektim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura nga Lungomare deri në Radhime të qytetit të Vlorës”, duke arritur në përfundim realizimin e sukseshëm të objektit dhe veprës.

Kategoria N.P-4 “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe nëlartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Kjo kategori licence përfshin natyrën e punimeve objekt kontrate dhe i referohet preventivit ku përfshihen edhe punime të tilla si: shtresë çakëll, shtresë binderi, shtresë asfalto betoni etj. Gjithashtu pas kryerjes së punimeve, shtresat dhe rrugët do të rehabilitohen e do të kthehen në gjëndjen e mëparshme.

Kategoria N.P-7 “Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje” *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.*

Kjo kategori licence i referohet **objektit të kontratës dhe punimeve kryesore** që parashikohen në preventiv për realizimin e veprës ku përfshihet rikonstrukcion rrjeti me zërat kryesorë furnizim vendosje tuba dhe rakorderi, ndërtimi i pusetave, etj.

Kategoria N.P. 12 “Punime të inxhinierisë mjedisore” - Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Kategoria NS -1 “Punime për prishjen e ndërtimeve”. Kjo kategori punimesh përfshin “*Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve*”. Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv gjatë realizimit të objektit të veprës, konkretisht ku është parashikuar zëri me Nr.15 Kodi 2.426/3 Prishje shtresa beton.

Kategoria NS-18 “*Punime topogjeodezike*”. Kjo kategori licence përfshin në mënyrë të thjeshtuar “*zbatimin e rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike*” etj. Eshtë kërkuar kjo kategori licence në përputhje me punimet që do të realizohen gjatë fazës së zbatimit duke u orientuar me kuotat, saktësinë e gjurmës së linjave, volumin e gërmimeve etj, bazuar në projekt preventivin e punimeve. Gjithashtu, sipas parashikimeve në specifikimet teknike dhe raportin topografik të publikuar, del e domosdoshme për piketimet e kanaleve që do të gërmohen, sistemit e volumeve të dherave dhe azhornimet topografike të cilat shtrihen në të gjithë nënobjektet e preventivit.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001 - 2015** (Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë), e përditësuar
- **ISO 14001-2015** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- **Certifikatë ISO 45001-2018** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- **BS PAS 99:2012** (Për sistemin e menaxhimit të integruar) e përditësuar

- **UNI EN ISO 3834-2:2006** (*Kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve metalike*) e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësiperme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi:

- **Certifikatë ISO 9001 - 2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësi, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.
- **Certifikatë ISO 14001-2015** “Për sistemin e menaxhimit të mjedisit” kërkohet pasi angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi, kurse metoda më efikase për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistem menaxhimi për mjedisin konform me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO 14001. Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 14001: 2015 është bërë pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontrates. Të gjitha punimet e parashikuara në veçori duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.
- **Certifikatë ISO 45001-2018** “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj.
- Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatorët ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj çertifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin,

kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

- **BS PAS 99:2012** “Për sistemin e menaxhimit të integruar” kjo kerkese siguron nje strukture per zhvillimin dhe zbatimin e nje sistemi te integruar te menaxhimit per perfundimin e objektit mkonform kushteve teknike dhe cilesise se kerkuar.
- **Certifikatë ISO 3834-2: 2006** “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim” është kërkuar për një cilësi sa më të mirë dhe precizion në saldimet që mund të kërkoen gjatë ndërtimit të objektit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencë të vlefshme:

- Kodi III.2.B - *Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ndryshme inerte dhe dhera si mbetje te parrezikshme (mbetjet që dalin nga punimet)*
- Kodi 1.2.A Sherbime ekspertize dhe /ose profesionale te mbrojtjes civile
- Kodi III.2.A (1+2) Sherbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me ndikim ne mjedis

Argumentimi:

- Kërkesa e mësipërme është përcaktuar e bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji*”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit Nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri*”.

Ndërkohë, sipas VKM Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “*Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme*”.

- Kodi 1.2.A Sherbime ekspertize dhe /ose profesionale te mbrojtjes civile ne rast emergjence per ruajtjen e sigurise ne objekt gjate zbatimit te punimeve.
- Kodi III.2.A (1+2) Sherbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me ndikim ne mjedis per te siguruar nje implementim te vepres per te shmangur ose minimizuar ne maximum ndotjet mjedisore gjate proceseve te ndryshme te punes ne objekt.

2.3.5 **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:**

Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **250 punonjes** për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik, stafi mbështetës inxhinierik, punonjes te specializuar Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.6 a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar , stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **1 Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni**1 Inxhinier Ndërtimi** (Profili Strukture)
- Minimuni **1 Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni **1 Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**
- Minimuni **1 Inxhinier Mjedis (specializuar per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe auditimin mjedisor)**
- Minimuni **2 Inxhinier Mekanik**
- Minimuni **1 Inxhinier Gjeoteknik**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Minimuni **1 Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni **1 Inxhinier Ndertimi**
- Minimuni **1 Inxhinier Ndertimi (Profili Transport)**
- Minimuni **1 Inxhinier Topograf**

Për inxhinierin e mësipërm duhet të paraqesë: kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar .

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

c) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi - jo më pak se **4** punonjës
- Teknik Topograf - jo më pak se **1** punonjës
- Hidraulik – jo më pak se **2** punonjës (ku minimalisht njeri prej tyre te jete i specilizuar per instalime dhe mirembajtje te rrjetit hidraulik)
- Saldator – jo më pak se **2** punonjës (ku minimalisht njeri prej tyre te jete i specilizuar per montim tubash)
- Hekurkthyes – jo më pak se **3** punonjës
- Karpentier – jo më pak se **6** punonjës
- Betonues – jo më pak se **4** punonjës
- Asfaltoshtrues – jome pak se **2** punonjes

* Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

❖ *Stafi i kërkuar në pikën 2.3.6 pika a,b dhe c , nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese me te njejtin autoritet kontraktor.*

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.6 pika a dhe b, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Ne lidhje me kërkesën Inxhinier Mjedis i specializuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, me certifikate leshuar nga Ministria e Mjedisit, në bazë të ndryshimeve të VKM Nr. 498 datë 01.08.2024 ku në nënin Neni 25 Kriteret e Kualifikimit, Paragrafi 3 përcaktohet:

“Autoritetet/entet kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77 të LPP-së, si edhe në hartimin e specifikimeve teknike, sipas parashikimeve të nenit 36, të LPP-së, të zbatojnë, përveç këtyre rregullave për prokurimin publik, edhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë vijon:

- a) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.”**

Në kriterin për punonjës të specializuar/të kualifikuar është kërkuar që operatorët ekonomikë të kenë të punësuar teknik për kryerjen e punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit. Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar / certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh.

Konkretisht janë kërkuar:

- 4 (katër) teknik ndërtimi
- 1 (nje) Teknik topograf
- 2 (dy) hidraulikë (ku minimalisht njëri është i specializuar për instalime dhe mirmbajtje të rrjetit Hidraulik)
- 2 (dy) saldatorë
- 3 (tre) hekurkthyes
- 6 (gjashtë) karpentier
- 4 (kater) betonues
- 2 (dy) asfaltoshtrues

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr.15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se.

- d) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin 1 (një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e individuale të punës,
- diplomën universitare.
- licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me çështjet e shëndetit në punë (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund të sigurojnë këto shërbime me anë marrëdhënieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në Nr.742, datë 06.11.2003), njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe

shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nënshkruajë kontratë shërbimi me një mjek të përgjithshëm.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”*.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”, për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme / Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

- 1 (një) **specialist Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 *“Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”*, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit nga data e hapjes së procedurës.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi:

AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010, *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”*, sipas të cilit: *„Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“*.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe

me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" si dhe Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Është kërkuar **Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar dhe ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Ky ekspert është i domosdoshem për të evituar ndodhjen e cdo situatë të paparashikuar si dhe mbrojtjen nga zjarri.

2.3.8. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga *Administratori i shoqërisë*) **Drejtuesin Teknik të punimeve** në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qenë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 (tridhjetë milion) në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë

veprimtari ndërtimi”. Kriteri i vendosur për disponimin e numrit prej mesatarisht të paktën 250 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në këtë përlllogaritje njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, dhe në perfundim, në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve.

Në staf përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar, drejtues të mjeteve të thjeshta apo të rënda etj, duke patur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve, grafikun, llojin dhe natyrën e punimeve që do të kryhen si: gërmime, ngjeshje, sistemime, shtrim tubacionesh, punime për pusetat, rehabilitimi i segmenteve rrugore etj, të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit të veprës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin rigoroz të punimeve.

Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e Drejtuesve teknik (Inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar **8(tete)** manovratorë/automakinist/eskavatorist/ buldozerist, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për muajin e fundit. Në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, dhe në çdo rast, *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Për stafin manovratorë të paraqiten: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë manovratorët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e tyre është kërkuar Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;

2.3.10(Makineri, Pajisje)

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues min 25 ton	3 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues min 15 ton	3 cope	Pronësi ose me qera
Kamioncine deri ne 3.5 ton	4 cope	Pronësi ose me qera
Rimorkiator për transportin e makinerive	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire	2 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me krahe te gjate	2 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	2 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 cope	Pronësi ose me qera
Minifadrome	1 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator me zinxhir gome	3 cope	Pronësi ose me qera
Fabrike betoni pajisur me leje mjedisore III.1.B	1 cope	Pronësi ose me qera
Fabrike asfalti pajisur me leje mjedisore III.1.B	1 cope	Pronësi ose me qera

Asfaltoshtruese	3 cope	Pronësi ose me qera
Rrul gome-hekur mbi 18 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshes asfalti min 8 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	2 cope	Pronësi ose me qera
Fshese me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Pajisje per largim te ujrave nentokesore me sistemin gjilperthithese (Well Point)	3 cope	Pronësi ose me qera
Cekic vibrues per ngulje palangolash	1 cope	Pronësi ose me qera
Autovinc	2 cope	Pronësi ose me qera
Aparat Saldim per ngjitje tubave PE	3 cope	Pronësi ose me qera
Aparat per bashkim tubash me elektrofuzin	3 cope	Pronësi ose me qera
Pajisje per testimin e presonit te tubave deri ne 40 bar	3 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	3 cope	Pronësi ose me qera
Gjeneratora mbi 100 kva	2 cope	Pronësi ose me qera
Palankola profile metalike	200 ton	Pronësi ose me qera
Sonde per shpime horizontale	1 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	2 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	3 cope	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri 4 cope	4 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator Betoni 4 cope	4 cope	Pronësi ose me qera
Prerese Asfalti	3 cope	Pronësi ose me qera
Frez asfalti	2 cope	Pronësi ose me qera
Kokore	50 cope	Pronësi ose me qera

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit:

Jelek	50 cope	Pronësi ose me qera
Prozhektor ndricimi	4 cope	Pronësi ose me qera
Tabela paralajmeruese	50 cope	Pronësi ose me qera
Komplet i ndihmes se shpejte	10 cope	Pronësi ose me qera
Fikese zjarri te levizshme	10 cope	Pronësi ose me qera
Semafor rruge	4 cope	Pronësi ose me qera
Depozita uji minimumi 5000 litra	1 cope	Pronësi ose me qera
GPS	1 cope	Pronësi ose me qera
Total Station	1 cope	Pronësi ose me qera
Kontenier (Zyrë Kantieri)	1 cope	Pronësi ose me qera

(akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik1” të ndryshuar, në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe

profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 te ndryshuar parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon.. mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi të kërkojë që operatorët ekonomike t’i disponojnë ato pasi nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve / makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, njësia është bazuar tek zerat dhe volumet e preventivit dhe specifikimet teknike të hartuara nga Projektuesi. Mjetet e kërkuara përkojnë me proceset ndërtimore dhe janë përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të veprës.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon çertifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomikë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshme paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit në lidhje me mjetet e pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

-Mjetet kamiona vetëshkarkues dhe kamioncina janë kërkuar për transportin e dherave apo materialeve që do të dalin gjatë zbatimit të punimeve, si dhe për transportimin e tubacioneve dhe rakorderive që do të furnizohen me qëllim realizimin e veprës për transportin e materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë kantierit sipas nevojave të punës dhe sasisë, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojiten mjetet kamiona vetëshkarkues dhe kamioncina me kapacitet mbajtës të ndryshëm.

-Referuar analizës teknike dhe preventivit mjetet eskavator me goma, minieskavator, fadromë me goma, etj, janë kërkuar për punimet si gërmime kanalesh, gërmime dheu, sistemime, etj, gjatë zbatimit të projekt preventivit.

Gjatë procesit të punës për zbatimin e punimeve të gërmimeve të dheut, nevojitet përdorimi i eskavatorëve dhe minieskavatorëve për secilin vëllim të objektit që do të ndërtohet. Në preventiv janë parashikuar shtresat asfaltike.

-Kërkesa për rul ngjeshës për asfaltime është bërë pasi në preventiv janë parashikuar edhe punime asfalti, ndersa mjeti autovinc është parashikuar referuar analizës teknike.

Mjetet Gjenerator, Sistem Wellpoint, Kontenier (Zyrë Kantieri) janë kërkuar si mjete të domosdoshme që duhet të disponojë një operator ekonomik por gjithashtu duke mbajtur parasysh edhe specifikimet teknike të publikuara nga ana e autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu nisur nga volumi i madh i ndërtimit dhe për menaxhimin sa më efikas të dokumentacionit teknik si dhe prania e stafit inxhinierik në objekt, përdorimi i të paktën një kontenier zyre vlerësojmë se është i domosdoshëm.

-Mjetet Prerëse asfalti / Sharrë asfalti janë kërkuar për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv si punime asfaltimi, prerje asfalti, punime shtresash etj, si dhe duke patur parasysh faktin se rruga do të kthehet në gjendjen e mëparshme.

-Autobetoniere, betoniere, pompë betoni janë kërkuar për realizimin e punimeve që kanë të bëjnë me betonin dhe beton arme me qëllim ruajtjen e markës së betonit sipas specifikimeve teknike.

Duke qenë se transportimi i betonit, të përgatitur në fabrikë kërkon procese dhe makineri specifike siç është autobetonierja, nisur nga sasia e punimeve të betonit dhe betonarmesë në preventiv, nevojiten këto mjete. Ndërsa pompa e betonit është e domosdoshme për ngritjen e betonit të freskët sipas planit të organizimit dhe teknologjisë përkatëse në punimet për realizimin e elementëve prej betoni të armuar.

-Autobot uji do të përdoret në momentet e ndërtimit të shtresave të ndryshme që do të realizohen në kantierin e veprës. Kjo makineri është e domosdoshme për të siguruar ujin e nevojshëm në materialet që do të ngjeshen, gjithashtu për të siguruar ujin e nevojshëm për proceset teknologjike në raste avarie të sistemit të furnizimit me ujë.

-Sonde për shpime horizontale me drejtim të kontrolluar është kërkuar pasi mund të lindë nevoja për përdorimin e tyre duke patur parasysh faktin se kemi të bëjmë me një zonë turistike, zonë e cila është në zhvillim të vazhdueshëm si dhe intensitetin e ndërtimit në këtë zonë. Për këtë arsye, gjatë zbatimit të punimeve, me qëllim parandalimin e dëmtimeve apo aksidenteve teknike të rrjeteve dhe faktin se mund të ndeshen rrjete të tjera nëntokësore, kërkohen këto makineri. Ndërsa mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier